

Mbirregullimi

Qeveritë duan të marrin vlerësim pozitiv në Vlerësimin e Ndërsjellë, pasi vlerësimi negativ ka ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen financiare të vendit. Ka prirje për mbirregullim të sektorit të OJF-ve dhe zbatimin e një qasjeje të njëjtë ndaj të gjithëve, në vend të një qasjeje të bazuar në risk. Kjo nuk është efektive si për qeverinë për sa i përket mandatit të saj në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ashtu edhe për OJF-të në lidhje me veprimtarinë e tyre të përditshme.

Organizatat jofitimprurëse (OJF) në të gjithë botën janë përballur me kufizime operacionale dhe ligjore. Kjo ka pasur një efekt negativ në aftësitë e OJF-ve për të zhvilluar aktivitete dhe për të mbrojtur nevojat e përfituesve, veçanërisht në zonat në situatë krize apo në konflikt.


Disa shembuj të mbirregullimit:

- kufizime në krijimin e organizatave: përfshirja e kërkesave të tepruara për licensim dhe qeverisje;
- kufizime në aftësinë për të advokuar për ndryshim: kufizimi i aftësisë së OJF-ve për t'u organizuar dhe etiketimi i mbrojtësve të të drejtave të njeriut si terroristë;
- kufizime në akses në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK);
- pengesa ligjore që dëmtojnë mundësitë e OJF-ve për të aksesuar financime të huaja në formën e granteve dhe donacioneve apo forma të tjera financimi;
- kërkesa të tepruara raportimi.

Pasojat e këtyre kufizimeve:

- Mungesë ushqimesh, ilaçesh, edukim, etj;
- Projekte të anuluar, më pak shërbime për komunitetet, etj;
- Burime të shpenzuara më tepër për transaksione bankare sesa për aktivitete në funksion të misionit të OJF-ve;
- Dëmtim i reputacionit të OJF-ve;
- Aftësi e kufizuar për të ngritur fonde për shërbimet e OJF-ve në shkallë vendi dhe përtej kufijve.

Deri kohët e fundit, këto kufizime justifikoheshin duke cituar kërkesat e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF) dhe, specifikisht, të Rekomandimit 8.



Kjo fletëpalosje u përgatit në kuadër të projektit "Organizatrat Jofitimprurëse në Shqipëri dhe Rekomandimi 8 i FATF", i cili financohet nga Projekti Global i GIZ 'Lufta kundër qarkullimit të paligjshëm të fondeve'.